



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1002/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Prishtinë, për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, për raundin e dytë të Zgjedhjeve Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 04.12.2013, morri këtë:

VENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Prishtinë .

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 02.12.2013 në ora 16:07 nga parashtruesi i ankesës LVV ku ka pretenduar se, me dt. 01.12.2013 rreth orës 13:00 në fsh. Mramor, në Qendrën e Votimit QV 1935E personat Kushtrim dhe Astrit Gashi të njëjtit djemët e Shefki Gashit – Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Komunës së Prishtinës, me veturë të markës Range Rover ngjyrë hiri, kanë hyrë në këtë qendër ku kanë zhvilluar fushatë për LDK-në dhe njëkohësisht duke bërë presion te qytetarët

Parashtruesi i ankesës ka theksuar se veprimet e kryera janë në kundërshtim me nenin 7 parag.1 pika b i Rregullës Zgjedhore 11/2013.

Parashktruesi i ankesës ka propozuar që në bazë të nenit 32.2 të LZP-së të shqiptohet sanksioni adekuar ndaj LDK-së dhe shkelësve të supozuar.

Në cilësinë e provës, parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur deklaratat e dëshmitarëve si provë .

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Me ankesën e parashtruar nga LVV-ja pretendohet se në Qendrën e Votimit QV 1935E është bërë fushatë dhe njëkohësisht është bërë presion ndaj qytetarëve nga personat Kushtrim dhe Astrit Gashi të njëjtit djemët e Shefki Gashit – Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Komunës së Prishtinës.

PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë ankimorë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu vërtetuar, pasi që mungojnë prova bindëse me të cilat vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar, prandaj ankesa vlerësohet si e pa bazë, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 1002/2013 më datën 04.12.2013.



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.